

VENDIM
Nr. 860, datë 21.10.2015

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 656, DATË 26.9.2012, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI, PRONËSIA, SHFRYTËZIMI, MIRËMBAJTJA DHE TRANSFERIMI NË FAVOR TË SHTETIT, TË PROJEKTIT TË HIDROCENTRALEVE MBI LUMIN DEVOLL"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 656, datë 26.9.2012, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në tabelën bashkëlidhur bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

- a) Ndryshohen të dhënat për pasuritë e zonës kadastrale 3624, fshati Trashovicë, në kolonën "Sipërfaqe shpronësimi", sipas të dhënave të përcaktuara në tabelën 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
- b) Shtohen pronarët e pasurive të paluajtshme që do të shpronësohen, sipas përcaktimeve në tabelën 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Në pikat 3 e 4, shuma "278 146 846.8 (dyqind e shtatëdhjetë e tetë milionë e njëqind e dyzet e gjashtë mijë e tetëqind e dyzet e gjashtë pikë tetë) lekë" zëvendësohet me "299 466 293.9 lekë (dyqind e nëntëdhjetë e nëntë milionë e katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e tre pikë nëntë) lekë".

3. Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"5. Vlera e shpenzimeve procedurale të shpronësimit përballohet nga shoqëria "Devoll Hydropower", sh.a.".

4. Kudo në përmbajtjen e vendimit, emërtimi "Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës" zëvendësohet me "Ministria e Energjisë dhe Industrisë".

5. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe shoqëria "Devoll Hydropower", sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Tabela 1

Korrigjim i sipërfaqes që shpronësohet

Nr rendor	NUMRI PASURISË	LLOJI I PRONËS	TIPI I PRONARIT	EMËR, ATËSI MBIEMËR	SIP E PARCELËS (m ²)	SIP E TRUALLIT (m ²)	SIP NDËRTIMIT (m ²)	SIP GJEOMETRIKE (m ²)	NUMËR ZK	FSHATI	KOMUNË	RRETHI	SIP. SHPRONËSIMI (m ²)
1	44/31	Arë	Privat	Alush Mustafa Çoku	2928	0	0	3253.08	3624	Trashovice	Pishaj	Gramsh	65.49
2	44/16	Arë	Privat	Estref Kadri Toçila	2640	0	0	2524	3624	Trashovice	Pishaj	Gramsh	45.02
3	44/33	Arë	Privat	Hasan Ali Avdiu	90	0	0	239.82	3624	Trashovice	Pishaj	Gramsh	239.82
4	44/15	Arë	Privat	Kadri Xhelil Toçila	3300	0	0	2886.91	3624	Trashovice	Pishaj	Gramsh	63.22
5	44/36	Arë	Privat	Kastriot Hysen Çekrezi	600	0	0	615.95	3624	Trashovice	Pishaj	Gramsh	34.56
6	44/18	Arë	Privat	Kujtim Qamil Çekrezi	2394	0	0	2163.66	3624	Trashovice	Pishaj	Gramsh	11.05
7	44/32	Arë	Privat	Kujtim Qamil Çekrezi	105	0	0	180.52	3624	Trashovice	Pishaj	Gramsh	180.52
8	44/10	Arë	Privat	Rexhep Zenel Ibra	2300	0	0	2649.65	3624	Trashovice	Pishaj	Gramsh	33.06
9	44/12	Arë	Privat	Rushan Hamit Çekrezi	2761	0	0	2810.43	3624	Trashovice	Pishaj	Gramsh	50.68
10	44/17	Arë	Privat	Sadush Murat Çekrezi	3724	0	0	3688.55	3624	Trashovice	Pishaj	Gramsh	48.82
11	44/14	Arë	Privat	Selim Hamit Çekrezi	2176	0	0	2436.64	3624	Trashovice	Pishaj	Gramsh	47.55
12	44/11	Arë	Privat	Sherif Nazif Toçila	4200	0	0	3882.34	3624	Trashovice	Pishaj	Gramsh	132.1